



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
NJËSIA E STREHIMIT SOCIAL

Nr. 1740 Prot.

Pukë, më 21.06 2022

PROJEKT-VENDIM

Nr. 3 Date 21.05 2022

PËR  
MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT LIGJORE, SISTEMIT TE PIKEZIMIT, MASËS SË  
QERASË, PER APLIKIMIN NE PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL, BANESA SOCIALE ME  
QERA

Mbeshtetur ne nenin 24 dhe 54 shkronja k) te ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", te nenit 16, 17, 20, 24, 30 te ligjit nr.22/2018 "Per Strehimin Social", ne perputhje me piken 5 te VKM nr.384, date 12.06.2019 te "Per Percaktimin e dokumentacionit per te perfituar strehim sipas çdo programi social te strehimit dhe te afateve e te procedurave te miratimit nga organet e Veteqeverisjes vendore", me propozim te Kryetarit te Bashkise, Keshilli Bashkiak,

VENDOSI:

- I. Te miratoje formularin tip 'A' "Kerkesa per te perfituar nga programet e strehimit social" si dhe formularin tip 'B' "Deklarimi tip per vertetesine e te dhenave" e gjitha kjo mbeshtetur ne piken 5 te VKM nr.384, date 12.06.2019 "Per Percaktimin e dokumentacionit per te perfituar strehim sipas çdo programi social te strehimit dhe te afateve e te procedurave te miratimit nga organet e Veteqeverisjes vendore"
- II. Miratimin e formatit te sistemit te pikezimit per programin e banesave sociale me qera sipas pikes 12 (a) te VKM nr.384, date 12.06.2019.
- III. Miratimin e mases se qerese per objektin Ish NSHN-se sipas nenit 30 te Ligjit nr.22/2018 "Per Strehimin Social" dhe VKM Nr.522, datë. 25.07.2019 'Për metodikën e llogaritjes të masës së qerasë për banesat sociale me qera', pika 7, sipas Raportit te Vleresimit te dates.20.05.2022, e shprehur hollesisht per çdo apartament sipërfaqe/qera.

IV. Per ndjekjen e zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Administrata e BashkisePuke.

Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për VeteqeverisjenVendore”.

V. U shpall me date \_\_\_\_\_

**Hartues**

**Behar ADEMI**

**Anjeza DODA**

**Pranvera TERBUNI**

**Juriste**

**Aida Sinani**

**KRYETARI**

**Gjon GJONAJ**





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA PUKE**  
**Njesia e Strehimit Social**

Nr. 1240/1 Prot

Pukë, më 21 06. 2022.

**R E L A C I O N**

**MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT LIGJORE, SISTEMIT TE PIKEZIMIT, MASËS  
SË QERASË, PER APLIKIMIN NE PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL 'BANESA  
SOCIALE ME QERA'**

**DREJTUAR :KËSHILLIT BASHKIAK PUKË**

Mbështetur neni 24 dhe 54 shkronja k ) të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisje Vendore", të kreut IV të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social", në përputhje me piken 5 të VKM nr.384, datë 12.06.2019 "Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e Vetëqeverisjes vendore".

Bashkia Puke ne kuadër te funksioneve qe ka ne drejtim te politikave sociale dhe kryesisht ne ofrimin e programeve te strehimit social ne Bashkine Puke si dhe nisur nga përfundimi i investimit per "Rikonstruksionin e godinës ish NSHN-se" financuar nga Ministria e Financave, duhet të paraqesë pranë Këshillit Bashkiak dokumentacionin tekniko –ligjor për Programin Banesa Sociale me Qera, për dhënien me qera të godinës së ish NSHN-se me, 8 apartamente.

- Miratimin e formularit tip 'A' "Kerkesa per te perfituar nga programet e strehimit social" si dhe formularin tip 'B' "Deklarimi tip per vertetesine e te dhenave" e gjitha kjo mbeshtetur ne piken 5 te VKM nr.384, date 12.06.2019 "Per Percaktimin e dokumentacionit per te perfituar strehim sipas çdo programi social te strehimit dhe te afateve e te procedurave te miratimit nga organet e Veteqeverisjes vendore, bashkelidhur formularet perkates.
- Miratimin e formatit te sistemit te pikezimit per programin e banesave sociale me qera, sipas pikes 12 (a) te VKM nr.384, date 12.06.2019. Kushtet e Pikezimit me Total jane 100 pike të ndara sipas programeve te percaktura ne ligje ndersa fushave përkatëse pikezimi do vendoset nga antaret e këshillit Bashkiak duke përcaktuar nga këshilli prioritet qe kane ne sherbim te nevojave dhe kushteve qe paraqet Bashkia Puke.

Theksojme se kriteret e vendosura nuk mund te ndryshohen pasi jane te percaktuara qarte ne ligjin nr.22/2018 date 03.05.2018 “Për Strehimin Social”, për “Banesat Sociale me Qera”

Formati i pikezimit tip do te perdoret per pikezimin e aplikimeve te cilat do kualifikohen ne fazen e dyte dhe te plotesojne gjithe dokumentacionin e kerkuar sipas ligjit.

Ky format pikezimi eshte ne perputhje me “Programin e banesave sociale me qera”

erftuesit nga programi i banesave sociale me qera behet sipas tabelës së pikëzimit që miratohet.

Theksojme se niveli i te ardhurave mesatare per Bashkine Puke percaktohet nga INSTATdhe do sherbeje si kriter percaktues per kualifikimin apo mos kualifikim e aplikimeve qe do behet nga struktura pergjegjese ne Bashkine Puke.

Në zbatim të nenit 20 , te Ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, nga fondi i banesave sociale me qera , jo më pak se 80 % e familjeve që përzgjidhen të trajtohen me banesa sociale me qera duhet të kenë të ardhura nga 0- 100 % të të ardhurave mesatare familjare, ndërsa pjesa tjetër, jo më shumë se 20 % e familjeve mund të përzgjidhen brenda intervalit 100- 120 % të të ardhurave.

- Miratimin e masës se qerases per objektin Ish NSHN-se sipas nenit 30 te Ligjit nr.22/2018"Per Strehimin Social" dhe VKm Nr.522, date. 25.07.2019 ‘Për metodikën e llogaritjes të masës së qerasë për banesat sociale me qera’, pika 7.

Masa e qerasë sipas formulës së paracaktuar me ligj është si më poshtë:

<b>Llogaritja e qerases me VKM 522, date 25.07.2019</b>				
Vlera e godines sipas pikes 7 te VKM Nr.522, date.25.07.2019 dhe Raportit te Vleresimit te dates 20.05.2022	16,000,000			
Qeraja vjetore e godines	480,000.00			
Qeraja mujore e godines	40,000.00			
Sip totale e godines	732.09			
Nr.Apartamentit	Sip Apartamentit	Pesha AP	Qeraja Mujore	Qeraja Vjetore
Apartamenti 1	86.95	11.88%	4,751	57,009
Apartamenti 2	86.75	11.85%	4,740	56,878
Apartamenti 3	93.18	12.73%	5,091	61,094
Apartamenti 4	92.95	12.70%	5,079	60,943
Apartamenti 5	93.18	12.73%	5,091	61,094
Apartamenti 6	92.95	12.70%	5,079	60,943
Apartamenti 7	93.18	12.73%	5,091	61,094
Apartamenti 8	92.95	12.70%	5,079	60,943
<b>TOTALI</b>	<b>732.09</b>	<b>100.0%</b>	<b>40,000</b>	<b>480,000</b>

Të ardhurata do të mblidhen në llogarinë ekonomike 'Të ardhura nga qera për banesat sociale'.

Për sa sqaruar më larte në relacionin tonë kërkojme miratimin e këtij projekt-vendimi dhe vazhdimin e procedurave ligjore për zbatimin e programeve për strehimin social në Bashkinë Pukë.

**Hartues**

**Behar ADEMI**  
**Anjeza DODA**  
**Pranvera TERBUNI**

*[Handwritten signatures]*

**KRYETARI**

**Gjon GJONAJ**



Nr.	1.Kushtet e strehimit	Totali piket 40 Shperndarje sipas fushes
1	Kanë ngelur të pastrehë si rezultat i rikonstruksionit të godinës ish NSHN, me ose pa kontratë me shtetin.	
2	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	
3	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore	
4	Banojnë në banesa me rrezik shembje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastrehë.	

Nr.	2.Kushtet familjaresipas nenit 16 te Ligjit 22/2018 'Per Strehimin Social'	Totali piket 20 Shperndarje sipas fushes
1	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna	
2	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore	
3	Familjet me më shumë se katër fëmijë	
4	Bashkëshortët, mosha e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç	

Nr.	3.Kushtet Sociale sipas nenit 16 te Ligjit 22/2018 'Per Strehimin Social'.	Totali piket 20 Shperndarje sipas fushes
1	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave	
2	Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç	
3	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirisimit të banesave ish-pronarëve	
4	Familjet e policëve të rënë në detyrë	
5	Viktimat e dhunës në familje	
6	Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;	
7	Anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian	
8	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit	
9	Vajzat nëna	
10	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.	
11	Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave përcaktohen familjet, sipas grupeve të të ardhurave, të përcaktuara në këtë ligj	

Nr.	4.Kushtet ekonomike	Totali piket 20 Shperndarje sipas fushes
1	Të ardhura nga 0 - 100 % të të ardhurave mesatare (80 % e perfituesve)	
2	Të ardhura 100 % -120 % të të ardhurave mesatare (jo me shume se 20 % e perfituesve)	

Shenim: Te ardhurat mesatare sipas INSTAT jane 26 000 lek per fryme.